



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPSHTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12,16 dhe 17 të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale NR.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 të datës 04.06.2008, Ligjit Nr.04/L-233 per Buxhetin e Republikës së Kosovës per vitin 2014 neni 4.2, 14 dhe neni 7.2 dhe LMFP, si dhe neni 20 paragrafi 20.1 te Statutit te Komunës së Lipjanit NR.110-623 te dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 27.02.2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

## VENDIM

PËR RRIJTJEN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT NGA TEJKALIMI I TË HYRAVE VETANAKE PËR VITIN 2019

### Neni 1.

Me këtë Propozim Vendim të bëhet rritja e planifikimit të buxhetit të të hyrave vetanake në shumë prej **165,298.83€**. Kështu që vlera e të hyrave vetanake të planifikuara nga **1,983,269.00€** rritet në **2,161,971.03€**.

### Neni 2.

Mjetet nga Neni 1 i këtij Vendimi planifikohen të destinohen si vijon:

#### Investime Kapitale:

##### Infrastruktura Publike (180) kodi i programit 18163:

Ndërtimi i pjerrinave për personat me aftësi të kufizuara në objektet publike dhe rrugët në Lipjan (projekt i ri) .....	9,300.00€
Ndërtimi i kroit në Kraishtë( projekt i ri).....	8,500.00€
Totali.....	17,800.00€

##### Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor(730) kodi i programit (73200):

Renovimi i objektit shendetesor ne Babush (projekt i ri).....	7,500.00€
Totali.....	7,500.00€

##### Shërbimet Kulturore (850) kodi i programit (85003):

Rregullimi i stadiumit në Dobrajë të Madhe dhe Magure-faza e II (projekt i ri).....	27,971.17€
Ndërtimi i sallës së sporteve në Kraishtë -faza e II (projekt i ri).....	31,027.66€
Totali.....	58,998.83€

##### Arsimi fillor (920) kodi i programit (93060):

Rregullimi i infrastruktures së jashtme në oborret e institucioneve edukativo-arsimore në K. e Lipjanit (projekt i ri).....	81,000.00€
Totali.....	81,000.00€

Totali i rritjes së të hyrave vetanake për vitin 2019 në krahasim me planifikimin e buxhetit është **165,298.83€**

**Neni 3.**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Neni 4.**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

**Neni 5.**

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

15Nr. 400-12506  
Lipjan, më 28. 02. 2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

